

DOKUMENT UDHËZUES

“Sjellja elektorale në Bashkinë e Durrësit, Shqipëri 2015”

Dorina Bërdufi

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës, Shqipëri

Ky “dokument udhëzues” mund të integrohet në kursin e “Metodave të kërkimit Cilësor dhe Sasior”. Përdoret nga studentët e programit të shkencave politike, në nivelin bachelor dhe master.

Duke qenë se ka të bëjë me sjelljen votuese të elektoratit lokal, mund që njëkohësisht të përdoret si një rast studimi, në formën e projektit kryesor të kësaj lënde. Kështu që studentët do të kenë mundësinë të punojnë me të gjatë gjithë semestrit dhe të prezantojnë rezultatet e tyre në fund të tij.

Përdorimi:

Faza I (2 orë): *Prezantim i problemit dhe praktikë në klasë*

Prezantim për sjelljen elektorale. Në këtë fazë studentët do të njihen me konceptin dhe çështjet kyçe të lidhura me problemin dhe kontributin e tij në zhvillimin e qendrueshëm demokratik.

Çështjet kryesore me të cilat do të punohet në këtë fazë janë:

1. Cila është sjellja votuese në Shqipëri?
2. Ndryshimet që kanë ndodhur në strukturën e saj?
3. Cili është impakti i kësaj sjelljeje në zhvillimin social, ekonomik, politik, etj. lokal?

Punë në klasë: Duke u fokusuar në elektoratin e Durrësit, studentët do të ftohen të shkruajnë dhe diskutojnë format kryesore të sjelljes elektorale dhe ndikimin e saj në arenën politike.

Faza II (1 orë): Leksion i hapur me ekspertë të procesit elektoral

Leksion i hapur me përfaqësues (ekspertë) të organizatave të fushës së studimeve politike. Në këtë leksion studentët do të marrin informacione shtesë të politikës shqiptare, veçanërisht në procesin e sjelljes votuese. Ata mund të diskutojnë sëbashku ato që mund të jenë disa nga temat rreth këtij problemi kërkimor. Në bashkëpunim me ekspertin do të mund të nënvijëzojnë disa nga pyetjet të cilat mund t'i integrojnë në pyetësor/intervista të cilat mund t'i zhvillojnë me aktorë të institucioneve lokale dhe vetë votuesin.

Faza III (4 orë): Punë në terren

Studentët do të ndahen në grupe të vegjël prej 3-5 personash. Secili grup do të realizojë një pjesë të kërkimit në terren, në zonat në të cilat ata jetojnë.

Faza IV (4 orë): Përpunimi i të dhënave dhe rezultatet

Studentët në bashkëpunim me profesorin do të deduktojnë rezultatet nga të dhënat e mbledhura.

Faza V (2 orë): Raportim dhe Bërja publike

Prezantimi realizohet nga studentët. Në bashkëpunim me profesorin ata do të vendosin mënyrën e bërjes publike dhe përhapjes së rezultateve të kërkimit të tyre. Disa ide mund të jenë:

- a) Publikimi në rrjete sociale si facebook;
- b) Publikimi në website-in e universitetit;
- c) Organizimi i tavolinave të rrumbullakëta me përfaqësues të politikës lokale;
- d) Publikimi në një gazetë lokale, etj.;